



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN

Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644 – 24 – 6677 – 1-2-1/C903
14 Nr. 674/24
Dt. 04.09.2024

KONTRATË FURNIZIMI

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson: – Ilmi Azemi – Drejtor Drejtorisë për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejme **PORORSITËSI**) , dhe
2. “ Sankos “sh.p.k. emri biznesit, me seli në Kaçanik, me ARBK: 811288134, të cilën e përfaqëson z. Xhavit Neziraj, në tekstin e mëtejme : **FURNIZUESI**

, janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike, për furnizime , si vijon:

Lot. 3 - Furnizim me veshembathje per shkollën profesionale , me numër identifikues:

| | | | | | | | | | |
|------------------|-------|---|---|----|---|---|---|---|---|
| Nr. i prokurimit | VU644 | 2 | 4 | 66 | 7 | 7 | 1 | 2 | 1 |
| Nr. i brendshëm | VU644 | 2 | 4 | 0 | 6 | 1 | 1 | 2 | 1 |

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe shërbimeve nga ana e Kontraktuesit, si vijon :
Furnizimi me veshembathje per Drejtorin e inspeksionit dhe zyrtart e tatimit ne prone, sipas Specifikimit Teknik dhe përshkrimit teknik të ofertës me nr. Referues : 644-24-061-121

Neni 2 Kushtet e dërgesës

- 2.1 Afati kohor për dorëzimin e mallit është : 35 (tridhjetëepesë) ditë kalendarike nga data e nesërme pas nënshkrimit të kontratës.
- 2.2 Mbikëqyrja e cilësisë dhe sasisë së liferimit dhe montimit, do të bëhet nga Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i Menaxherit të Kontratës i Autoritetit Kontraktues, i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues. Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Menaxherit të Kontratës, Mbikëqyrësit të Menaxherit të Kontratës si dhe Komisionit të Pranimit të mallit .
- 2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).
- 2.4 Kontraktuesi, para nënshkrimit të kontratës, do të dorëzoi tek A.K. Sigurimin e ekzekutimit të kontratës 10% (dhjet përqind) e vlerës së përgjithshme të kontratës. Dokumenti-Polisa e sigurimit apo dokument bankar me afat validiteti për perjudhen kohore prej 75 ditësh nga data e specifikuar për lidhjen e kontratës.
- 2.5 Garancioni për cilësinë dhe përshtatshmërinë e mallrave do të jetë përgjegjësi e Furnizuesit. Afati i garancionit fillon nga data e pranimit të mallit dhe përfundon në një afat prej minimum 12 muajve nga data e pranimit të mallit nga Mnxheri dhe Komisioni i Pranimit të mallit. **Dokumentit – Deklaratë e lëshuar,**

¹⁷ DDP – Dërgesat e Detyrës të Paguara –Incoterms 2010 Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.

nënshkruar dhe vulosur nga Furnitori për kualitetin e mallit me afat validiteti për kohëzgjatjen e periudhës prej 13 muaj nga data e pranimit të mallit.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: 3,540.00€ (tremijpesqindedyzet/00€).

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër është i prerë, nuk do të nënshtrohet ndryshimeve dhe, është e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit / Kryesit të shërbimeve, sipas Kontratës.

3.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës, respektivisht sipas Raportit të prezantuar – dorëzuar nga Menaxheri i Kontratës si dhe Komisioni i Pranimit të mallit.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e përgjithshme dhe të Veçanta të kontratës
- (c) Aneksi 1. Specifikimet Teknike të Detyrueshme
- (d) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (e) Plani për menaxhimin e kontratës;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.



5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënie e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe² në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Operatorin Ekonomik:

“ Sankos “sh.p.k. – Kaçanik

Për Autoritetin Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë

| | | | |
|-------------|---|-------------|--|
| Emri: | Xhavit Neziraj | Emri: | Ilmi Azemi |
| Pozita: | Menaxher | Pozita: | Drejtor i Drejtorisë për Prokurim Publik |
| Nënshkrimi: |  | Nënshkrimi: |  |
| Data: | 04.09.2024 | Data: | 04.09.2024 |
| Vula: | | Vula: | |

² Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

Lot 3

Shënimi 1: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G. Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar

| Nr. | Përshkrimi i pozicioneve | Njësia Matëse | Sasia | Çmimi për njësi pa TVSH | Norma e TVSH-së në % | Çmimi për njësi (me TVSh)-€ | Totali (Pa TVSH) | TVSH | Totali (me TVSH)-€ |
|------------------|--|----------------|-------|-------------------------|----------------------|-----------------------------|------------------|---------------|--------------------|
| | | | | | | | | | |
| 1 | Komplet (set) i veshjeve per pune ne Kuzhinë (kapele, kemisha per kuzhinier, maica, pantollona, kecele, mbathje) me numra te ndryshem per nxënës dhe staf) kualitet.Set duhet te jetë nga materiali cilësor që të hekuruset lehtë dhe ta mbaj hekurin me permbytje 65% pambuk dhe 35% poelister gramazha 250gr.Mbathjet duhet të jenë anatomike dhe antistatike dhe kualitative nga lëkura | | | | | | | | |
| | | Palë(ko mplet) | 25 | 100.00 | 18.00 | 118.00 | 2,500.00 | 450.00 | 2,950.00 |
| 2 | Komplet (set) i veshjeve per kamarier (Setra,kemisha, pantollona, kravata, mbathje) me numra te ndryshem per nxënës) kualitet.Set duhet te jetë nga materiali cilësor që të hekuruset lehtë dhe ta mbaj hekurin me permbytje 65% pambuk dhe 35% poelister gramazha 250gr. Mbathjet duhet të jenë anatomike dhe antistatike dhe kualitative nga lëkura | | | | | | | | |
| | | Pale(ko mplet) | 5 | 100.00 | 18.00 | 118.00 | 500.00 | 90.00 | 590.00 |
| TOTALI II | | | | | | | 3,000.00 | 540.00 | 3,540.00 |

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)

| | |
|---|----------------|
| EMRI I OE: | "Sankos" shpk |
| EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE: | Xahvit Naziraj |
| NËNSHKRIMI: | |
| DATA: | 09.08.2024 |
| VULA: | |